**VENDIM**
**Nr. 764, datë 7.11.2012**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË NJËSISË ADMINISTRATIVE BILISHT, BASHKIA DEVOLL TË QARKUT TË KORÇËS**

*(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 27.1.2021[1])*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të *Njësisë Administrative* Bilisht, Bashkia Devoll të qarkut të Korçës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 386 (treqind e tetëdhjetë e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Bilisht për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Bashkia Bilisht — Lidhje 1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 1, 2 | Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). | Në përdorim |
| 3, 4, 111 | Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive). | Në pronësi |
| 37 - 45 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile. | Në pronësi |
| 348 – 358, 121 - 330 | Infrastrukturë ( Sheshe, lulishte dhe shërbime publike), rrugë vendore. | Në pronësi |
| 51 - 54 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore . | Në pronësi |
| 55 | Prona që përdoren per realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social. | Në pronësi |
| 56 – 58, 60 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive. | Në pronësi |
| 61 | Varrezat publike. | Në pronësi |
| 332 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën ndriçimit publik. | Në pronësi |
| 359 - 371 | Troje të lira dhe hapësira të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji. | Në përdorim |
| 372 - 378 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës – kanalizimeve. | Në pronësi |
| 49, 9, 10, 12-36 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik. | Në pronësi |
| 50 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës. | Në pronësi |

[1] *b) Në listën e inventarit, bashkëlidhur vendimit, të dhënat e pasurive 1/7 dhe 1/8, të llojit "truall", me vendndodhje në zonën kadastrale 1187, të ndryshojnë sipas formularit gjithsej 1(një) fletë dhe hartave kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.*
*c) Në lidhjen 1, bashkëlidhur vendimit, pasuritë e përcaktuara në shkronjën "b", të kësaj pike, të transferohen në pronësi të Bashkisë Devoll, për Njësinë Administrative Bilisht, me qëllim për t'u përdorur në fushën e strehimit dhe të shërbimeve sociale.*

*(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 27.1.2021)*

## 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

**(Per inventarizimin e pronave te veçanta)**

Identifikoi: **Manjola Hanelli** Specialiste ne SZHT
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Bashkia DEVOLL

Supervizoi: **Nikol Sulenji** Specialist Ing.Gjeodet SPZHT
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Fisha e përdorimit të Pronës:" **Për ndërtim apartamenti nga EKB dhe Qendër Sociale multifunksionale nga UNDP**

Aprovoi: **Eduard Duro Kryetar i Bashkise**
**(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)**

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Rend | Zona Kadastr & indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones<br>Adresa | Sip. Totale e Prones ($m^2$) | Nga Sip Totale: Sa Ndertese ($m^2$) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues. Statusi juridik i perdoruesit | Te dhena te tjera<br>(shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 1187<br>BI-F-4 | .1/7 | Truall | Bilisht | 875 | | Ndërtesë | Bashkia<br>Devoll | Bashkia<br>Devoll | |
| 2 | 1187<br>BI-F-4 | .1/8 | Truall | Bilisht | 1037 | | Ndërtesë | Bashkia<br>Devoll | Bashkia<br>Devoll | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

# HARTE KADASTRALE
## (Fragment)




*(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 27.1.2021)*

# HARTE KADASTRALE
## (Fragment)




***(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 27.1.2021)***